

BIBLIOTEKA


E

DJH-1

C 13

SHTETIT

GJIROKASTËR



**Aleks Çaçi**

AROMA  
E TOKËS

POEZI

81H-1  
- 913.

# Aleks Çaçi



## Aroma e tokës

POEZI

11744

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## A T D H E

Ti je gatuar me djersën,  
që derdhën të parët gjatë shekujve,  
me djersën që sot derdhim ne.  
Ti ke në damarët e tu gjakun që u derdh për ty,  
kallot e punëtorëve e të argatëve,  
ke, o atdhe, të rrahurat e zemrës  
të të gjithëve, qëkur ti linde  
dhe deri sot,  
ke eshtrat e atyre që ranë për ty,  
eshtrat e nënës sime që të puthte çdo mëngjes  
para se të shkonte në punë,  
ti më ke mua që të rri ngjitur,  
sytë e mi që të shikojnë thellë,  
duart e mia që të mbajnë shtrënguar,  
do më kesh, o atdhe,  
përgjithmonë, në gjirin tënd.

## NUK I HARROJMË!

Nënat tona gjithë natën përgjonin,  
dridheshin nga të ftohtit.  
Na u vranë shokët më të mirë.  
Doja të numëroja lapidarët,  
s'i numërova dot, si yjet.  
Akoma kam në sytë e mi  
gjurmët e vështrimit të tyre.  
Nuk i harrojmë!

## NË DORËN TIME

Në dorën time kanë mbirë rrudha,  
nuk i numëroj dot.  
Rri e mendoj, ç'ka zënë vallë?  
Një herë, kur nëna ish sëmurë,  
dorën ia vura mu në ballë.  
Dhe që atëherë kjo rrudhë ruhet  
Kur e shikoj, unë e di mirë,  
një rrudhë e tillë kurrë nuk shuhet!

## KËSHTU VAZHDONTE JETA

Në xhep mbaja një copë bukë,  
gjithë ditën i mirrja erë, ngopesha.  
Shkundja xhepin  
dhe mblidhja thërrimet që më kishin mbetur.  
Nëna zgjaste sahanin nga gardhi,  
plaka Margalinë ia mbushte me miell.  
Të nesërmen, nëna ia kthente.  
Kështu vazhdonte jeta gjithnjë.  
Më jep hua, të jap hua.  
I kam fotografuar, o nënë,  
duart e plakës Margalinë  
dhe duart e tua.

## NËNA NUK QAU

Nëna nuk qau kur i treguan kufomën e të birit.  
N'ato çaste i doli përpara gjithë vegjëlia  
dhe i tha se atë e vranë për lumturinë e të tjerëve,  
për më shumë bukë,  
për më shumë diell.  
Ajo iu kthye të birit të vranë dhe i tha:  
— Edhe të vdekur, nëna  
brenda në gji të ka!

## TË GJITHA MË MUNGONIN

Të gjitha më mungonin.  
Dhe në shtëpi brenda, rrezet e diellit hynin  
dhe dilnin me nxitim, nuk donin të qëndronin.  
Kur vinte nata, zemra ime  
nuk kishte qetësi.

Të gjitha më mungonin.  
Vetëm kujdesi yt, o nënë,  
dhe sytë e tu të ëmbël,  
gjithnjë  
afër më qëndronin.



## LOTI

Nuk kam qarë kur s'kisha,  
as kur ecja rrugëve, duke kërkuar punë,  
as kur e ndjeva veten ngushtë,  
kur donin të më vrisnin,  
se doja të takohesha me dritën.  
Qava vetëm, kur nëna qau,  
se i kërkova bukë dhe s'më dha,  
të flija, më tha.  
Të nesërmen e pashë që qeshte,  
me vështrimin e saj më mbushi me ëmbëlsi,  
edhe atëherë, një lot më ra në tokë përsëri.

## DHE UNË ME TË

Është e vërtetë. Atë ditë  
isha dhe unë atje.  
U ngrit dhe patronit me zemërim i tha:  
— Nuk të duroj më, këtë ta dish,  
s'punoj më dot për ty.  
Dhe punëtori ngriti grushtin lart.  
Ka qenë viti tridhjet' e gjashtë.  
Dhe unë me të  
rrugën e nisëm bashkë.

## SHOKËVE TË RËNË

Buzëqeshjen e lanë në mes,  
edhe shpresën e lanë në mes,  
po i morëm ne,  
edhe buzëqeshjen,  
edhe shpresën e tyre,  
i bashkuam  
me buzëqeshjen dhe shpresën tonë,  
dhe ecim bashkë me ta,  
ata erdhën me ne,  
vijne me ne,  
drejt, larg, mirë.

## AKOMA MË DJEG

Sa duar shokësh kemi shtrënguar,  
kur ndaheshim dhe s'dinim a do të takoheshim?  
Akoma më djeg pëllëmba e dorës,  
ku mbanim, atëherë, ditët që jetojmë.

## SA SHUMË GJAK

Fytyrën ia kam harruar,  
emrin ia kam harruar.  
Vetëm mbaj mend fjalët e tij,  
që kishin ngjyrën e agimit të mëngjesit.  
Edhe natën luftonte me natën.  
Kur, në një betejë me armiqtë,  
që i kishin zënë pusi,  
ra,  
vetëm këto fjalë tha:  
— Sa gjak kërkon, o drejtësi!


## K È T U

Kur beteja mbaroi,  
u bë apeli.  
Shokët që mungonin,  
nuk u përgjigjën atë ditë.  
Pas çdo beteje ndodhte kështu.  
Sot dëgjon kudo: këtu, këtu, këtu!

## KUR U NDAMË

*Sadik Staveleci*

Kur u ndamë, ishte natë.  
Ai kollitej dhe qeshte.  
Po iki, më tha, larg...  
Nesër...  
Atë natë ndënji në shtëpinë e lagjes së varfër,  
po fashistët e rrethuan,  
vrau sa mundi,  
pastaj ra.  
Gjithnjë kaloj andej,  
më duket se e shikoj përsëri.  
O shok, i them,  
unë eci në rrugën që zumë bashkë, ti e di.



117744

## EDHE TI

Kur të shpumë në varr, nuk gamë.  
Tokën e gërmuam me duart që mbanim dyfekët.  
Mbi varr lamë një dritare të vogël  
që të shikoje urrejtjen që kishim për armikun.  
Pastaj u nisëm. Shi, dëborë, përpjekje, uri.  
Kur fituam,  
bashkë me ne këndove edhe ti.



## A Ì

U takuam një natë, pastaj shumë netë,  
as ia thashë emrin, as ma tha.

Vetëm ecnim bashkë,  
mendnim njësoj,  
shikonim,  
qeshnim, prisnim njësoj.

Ai ra,  
unë akoma emrin s'ia di.

Kur kaloj nga vendi kur u pamë herën e parë,  
më duket sikur më del përpara ai.

## DHEU NUK E TRETI

I thoshnim shoku i furtunave.  
Në zemër mbante shkrepëtima.  
Kur grushtin shtrëngonte,  
mbante brenda zemërime  
dhe kur e hapte,  
toka mbushej me gjëmime.  
Kur ngjitej malit,  
në foletë e tyre e prisnin shqiponjat.  
Kur sulmonte,  
shqiponjat e mirrnin mbi krahët e tyre.  
Kur mbështeste këmbët mbi tokë,  
toka jonë ia përkëdhelte.  
*Kur ra në një betejë,*  
*u ngrit edhe një herë më këmbë,*  
dhe ashtu mbeti,  
dheu nuk e treti.

## NË TOKËN TONË KA LËNË

Vetëm një natë në një mbledhje e pashë,  
pastaj u ndamë.

Ku do të jetë? Shumë herë kam thënë.

Në flamujt që shpalosen fitimtarë,

në fushat me kallinj,

në agimin e mëngjesit që na vjen...

Ngado që shkoi ai,

gjurmë të thella

në tokën tonë ka lënë.

## Û ULËM VETËM NJË HERË

Zinxhirët i thyem,  
me krahët e shqiponjës,  
fluturuam lart e s'u ulëm,  
u ulëm vetëm një herë,  
kur morëm në dorë tokën tonë  
përgjithmonë.

## FLAMUJ TË KUQ VALOJNË

Flamuj të kuq valojnë,  
rrugët janë plot.

Dhe m'u kujtua,  
tridhjet' e pesë vjet si sot,  
në ëndërr e kisha parë  
këtë ditë.

Kushedi, bëhet e vërtetë? —  
ahere kisha thënë,  
dhe krahë të fluturoja  
ëndrra më kish dhënë.

## KE HIPUR MBI MAJËN E KULLËS

Ke hipur mbi majën e kullës dhe punon.  
Me sytë e tu dhe mua më ke marrë.  
Dhe unë jam me ty, aty,  
shikojmë Shqipërinë që të dy.  
Po s'jemi vetëm ne.  
Asnjë s'ka mbetur, të gjithë kanë ardhur.  
Edhe të verbërit, që s'kanë sy.

## DJERSA IME

Ku ka shkuar djersa ime,  
ku do jetë vallë?  
Gjithë djersa ime  
ra mbi këtë tokë.

Unë jam biri i djersës,  
vëllau i diellit.

Me djersë u laga,  
sa u kënaqa!

Ku ka shkuar djersa ime,  
ku do jetë vallë?

U bë bukë,  
u bë jetë.

Ata që punojnë, mund të bëjnë  
me djersën e tyre, një det.

## Ë R I N I

Po kthehesh prapë? Po u ktheve,  
ta dish si do të ngjitem lart!  
Tani e shoh se çdo të thotë rini.  
Krahë do bëj të fluturoj,  
për mua natë s'do të ketë,  
tokën me duar do ta gërmoj,  
thesare do kërkoj,  
shtëpi me shumë kate do bëj vetë,  
me djersë do ta vadis gjithë Shqipërinë,  
do marr në dorë gjithë bukurinë.



## SOT NGRE DOLLI

Sot ngre doli me verë të kuqe.  
Tarracat janë mbushur me hardhi.  
Rrushi është pjekur dhe me tokën puthet,  
kanë rënë që të dy në dashuri.  
I dehur edhe unë sjell ndër mend  
kohën, kur zemërvrarë ishte ky vend.

## URIA RRI SI KËRCËNIM

Një herë ecja rrugës duke fërshëllyer,  
duart i mbaja prapa,  
kërkoja punë.  
Në mbrëmje, kur u ktheva në shtëpi,  
i lodhur, i këputur,  
shtrëngova grushtin me zemërim  
dhe, që nga ajo kohë,  
kështu qëndron ky grushti im,  
se, akoma në botë,  
uria rri si kërcënim.

*Një rrugë*

## NJË ÇIKË

Edhe sot kërkoj një çikë ujë,  
një çikë bukë,  
kërkoj një çikë diell  
dhe pak fjalë,  
gjithnjë një çikë...  
Po. Ky zakon më ka mbetur.  
Të gjitha një çikë ishin atëherë.  
Këtë fjalë një çikë e mësova  
që në barkun e nënës.  
Të gjithë thoshnin,  
bukë, një çikë.  
Qumështi që piva nga gjiri i nënës,  
pikë-pikë.

## CËRKAMI

*Cërkami\** punonte vetëm në verë.  
I ndiqte kokrrat e thekrës me rrëmbim.  
Kur binte ndonjë përdhë,  
e mblidhnim.  
Më një anë thneglat, më një anë ne.

---

\*) mulli i vogël që punon në verë.

## NË NJË GUFALLË

Në një gufallë kam lënë një kujtim.  
Një copë prefull që nëna më kish dhënë.  
Gjithë atë ditë milingonat  
venin e vinin pa pushim.  
Në mbrëmje s'kishte mbetur gjë.  
Gjithë atë dimër milingonat  
e kishin barkun plot.  
Sa herë minjtë e fushave i sulmonin  
në gufallë,  
nuk hynin dot.

## LUBIA PADREJTËSI

Para se të vinte në gojë bukën,  
e shikonte.

Më kujtohet. Kur mbaronte së ngrëni,  
thoshte kam. uri.

Punonte dhe s'gopej.

Ia pinte djersën  
lubia padrejtësi.

## RRI PRANË SHKËMBIT

Rri pranë shkëmbit e shikoj.  
Sikur më flet,  
tufane shkuan përmbi mua,  
donin të më rrëzonin,  
s'më bënë gjë.



## DRËNJË

Një *drënjë*\* kishim pasuri.  
E kishim si fëmijë.  
Unë e kullosja në një breg me gurë.  
Në mbrëmje,  
kur ktheheshim të dy për në shtëpi,  
ajo përpara, unë pas,  
ishim tërë gaz.  
Pastaj e milnim,  
mblidheshim të gjithë.  
Ajo shikonte dhe, si duket,  
kërkonte  
që të na jipte qumësht sa më shumë.  
Dhe ngrinte kokën lart,  
brirët lëvizte  
dhe,  
sikur me inat,  
dikë donte të qëllonte.

---

\*) dhi laramane.

## DO TË NDAHEMI

Do të ndahemi,  
kështu i thashë nënës atëherë.  
Dhe në mos u kthefsha,  
ti më prit. Unë do të vij.  
Bashkë me flamujt e kuq do të jem dhe unë.  
Ditën e fitores ajo më pa  
dhe thirri duke qeshur: ja!...

## EDHE VETEN TËNDE DO BËJE FLI

Edhe në qoftë se ti nuk je këtu,  
sytë e mi janë plot me ty, —  
dalim bashkë nga shtëpia,  
me ty shkoj për të blerë libra të reja,  
udhëve me njerëz shumë, shëtisim bashkë,  
kur shkoj unë në punë, vjen edhe ti me mua,  
në shfaqjen e fshatit të kam pranë,  
dëgjon edhe ti këngët që gjëmojnë,  
përpara lapidarit ti duartrokit kur flas,  
kur nënën tënde takoj, je edhe ti aty,  
ajo qesh kur më sheh  
se mendon,  
që jemi krah për krah të dy,  
si dikur.  
Kur shkruaj,  
ti më pyet për fjalën që thamë ditën e parë,

kur ndënjëm gjithë natën bashkë në një shtëpi  
dhe ti  
me grushtin lart u betove  
se për popullin, edhe veten tënde do bëje fli.

## DRITË TË KUQE MORI NGA AI

Kur qeshte, e kisha parë gjithnjë,  
sikur nga buza e tij dilte agimi.  
Sa herë fliste, sytë e mi  
shkëndija nxirrnin nga gëzimi.  
Dhe kur në luftë ra me grushtin lart,  
duke thirrur, bie për liri,  
qeshi dhe dielli,  
dritë të kuqe mori nga ai.

## VARRET E TË PARËVE JANË KUDO

Varret e të parëve janë kudo.  
Ata nuk vdiqën. Ata ranë duke luftuar.  
Të gjithë, plumbin në ballë e kanë marrë.  
Atdheu i di ku janë.  
Po t'u bëjë thirrje, të gjithë do të mblidhen  
të veshur me armë.  
Do marrin me vete malet,  
lumenjtë dhe shkëmbinjtë që rrokullisen nga mali,  
grykat dhe monopatet,  
do ngrenë në krahë tokën tonë.  
Të gatshëm do të jenë,  
me ne të gjallët,  
të gjithë  
në vijën e parë.

## K A Ç A S T Ë

Ka çaste kur gëzimi im derdhet si lumë.  
Më janë mbledhur në zemër gëzimet e vjetra,  
kur rroja me ëndrrat e së ardhmes.  
Pastaj u shtuan gëzime të tjera,  
kur shikoja se po rrëzohej godina e padrejtësisë.  
Sot vërshojnë të tjera gëzime.  
Sa shumë nxëka kjo zemra ime!

## KALLOT

Kallot që kam në duar,  
mund t'i këndosh, po të duash.  
Janë një libër i madh.  
Thonë se bota, që të ndërtohet,  
kërkon djersë,  
netë pa gjumë,  
dritë në zemër shumë.  
Kallot, o poet,  
futi në vjershat e tua.  
Pa kallo, unë vjersha nuk dua.



## POSTJERI MË SOLLI NJË LETËR

Postieri më solli një letër.  
Zarfi s'kish adresë.  
Diku në Shqipëri, thosh.  
S'më njeh njeri, po si më erdhi?  
Pyetën njëri-tjetrin,  
derisa një ditë gjetën adresën e vjetër.  
Është ndërtues, sot këtu,  
nesër në një vend tjetër.

## NË ZEMRËN TIME

Çeli bajamja që kam në dritare.  
Edhe fëmijët e lagjes çelin.  
Çel çdo gjë që mbjellim.  
Edhe në zemrën time çeli një gëzim.  
tani s'jetoj më pa qëllim.

## KUR BINTË SHI

Kur binte shi, një pjesë e pinim edhe ne.  
Pikat na rëndonin,  
dhe kur dilte dielli, avullonin dhe iknin.  
Toka na shikonte dhe i vinte keq.  
Ne rrinim gjithë ditën në arë,  
pastaj toka lëshonte lastarë.

## S'ËSHTË MË

Rrija dhe shikoja fushën e gjerë.  
Doja të kujtoja kasollen që ish dikur.  
Sa herë fjeta atje,  
sa herë fërkoja sytë nga tymi që s'dilte dot jashtë,  
sa herë u laga nga shiu që binte brenda,  
sa herë ëndërroja një shtëpi të mirë...  
S'është më, më thanë,  
n'atë vend është ngritur një pallat i bukur,  
kasollja me kashtë, për pleh është shkrirë.

## PO KËTË HERË DIELLI S'ISH AI

Në fushë kanë dalë qëmenatë  
agimi me vajzat bashkë  
dhe dielli nxitohet t'i shikojë.  
Çelin lulet që kanë mbirë.  
Fryn erë e lehtë  
dhe zogjtë fluturojnë në qiell të lirë.  
U ktheva përsëri në këto anë,  
i qetë, dhe shikoj ku ndodhem vallë?  
Kur papandehur gjendem  
me diellin ballë për ballë.  
Po këtë herë dielli s'ish ai,  
që kisha parë shumë vjet më parë.  
As unë e njoha, as ai më njohu,  
s'ishim më, si dikur, të vrarë.

## DHËMBËT I KISHIN RËNË

Shtëpinë e parë në fshat e përshëndeta.  
I thashë tungjatjeta.  
Aty u mblodhën dhe shtëpi të tjera,  
të lyera, të bukura, të reja.  
Në fund qëndronte një kasolle,  
që më hodhi sytë me habi.  
Mëjanë e kishin lënë.  
Donte të qeshte, po, kur e pashë,  
dhëmbët i kishin rënë.

## AJO DORË

Me grusht e mblodha dheun edhe unë  
dhe mbi një shkëmb e hodha.  
Kjo dora ime e vogël,  
o, sa herë u përpoq  
me shkëmbin shekullor.

Nën hijen e ullirit që ka mbirë,  
udhëtarët që kalojnë  
i mbushin mushkëritë  
me erë të lirë.  
Degët e ullirit  
janë bërë si kurorë.  
Udhëtarët, kur flasin, thonë:  
«Mos u trettë kurrë ajo dorë!»

## S'NUMËROHEN DOT DOLLITË

Kur hyri në shtëpi ditën e parë,  
nuk fliste dot, sikur u bë memec.  
Pse kaq kohë ndënji n'errësirë,  
ai, stërgjyshërit e tij, me mijëra vjet?  
Dhe sot shtëpia ndrit, hyn dielli vetë.  
Janë mbledhur e festojnë këtë ditë.  
Kanë ardhur, brez pas brezi, që të gjithë.  
O, ç'bëhet, s'numërohen dot dollitë!



## Ç'DHEMBJE DO TË NDIEJ

Një natë,  
në një dhomë përdhese, në fund të qytetit,  
ku ishim mbledhur të munduarit,  
të ndjekurit,  
të shfrytëzuarit,  
dëgjova fjalën komunist.  
Ish hera e parë që jetoja botën e ardhshme.  
Lashë mënjanë çdo gjë.  
Dhe me botën e ardhshme jetova gjithnjë.

Kjo fjalë, komunist,  
kërkon vështirësi, bukuri, pastërti.  
Edhe kur të vdes,  
ç'dhembje do të ndiej,  
që do ta lë këtë fjalë,  
vetëm unë e di.

## NJË RRUGË

Një rrugë e ngushtë, —  
në këtë rrugë eca shumë  
natën n'errësirë,  
dorën në xhep e mbaja,  
një copë qiell dukej lart  
dhe ndonjë yll,  
që ditën më tregonte.  
Kjo rrugë e ngushtë si përgjëratë,  
pas shumë vjetësh,  
më nxori në një tjetër,  
të gjerë dhe të gjatë.

## TI RRI ME LULEN BASHKË

Ti rri me lulen bashkë.

S'të dalloj dot.

Të dy, një ditë lulëzuat?

Shpërthyhet, nuk duruat.

U mblodhën gjithë fluturat

mbi ju.

Vetëm një bukuri të tillë ka këtu.

## RREZET E AGIMIT

Rrezet e agimit më ledhatojnë fytyrën.  
Kalojnë përmes rrudhave,  
rrudhat nuk duken më.  
Vetëm agimi ynë e bën këtë gjë.

## AVERMA

Një ditë *averma*\* e opingës u takua  
me ferrën e shtëpisë.  
Rrashë dhe qava atë ditë,  
isha fëmijë dhe nuk dija  
se gjithë jeta është një avermë,  
që herë këtu pengohet, herë atje,  
po ti s'qëndron, ti ecën ballëlartë  
dhe bën një hap tjetër përpara,  
një hap më shumë se dje.

---

\*) gjalmë që lidh opingat.

## FURATË

Furata ish e gjatë,  
deri në majë t'ullirit.  
Në dorë e mbaja.  
Dhe trupi im i vogël dhe i thatë  
më këmbë s'qëndronte dot.  
Qehajai më shikonte me inat.  
Unë, atë shikim,  
e ruaj në sytë e mi dhe sot.  
Këtë që më kish ndodhur atëherë  
fëmijëve ua tregova.  
Ata, nga zemërimi,  
derdhën lot.

## GARDHI

Një copë qiell varej mbi shtëpinë.  
Gardhi me ferra frymën i shtrëngonte.  
Rrezet kur hynin, dërsinin.  
Era kthehej përsëri.  
Dhe njerëzit që rronin këtu brenda,  
t'i shihje,  
sikur s'ishin  
dhe të mendonin s'kishin mundësi.

Kur gjerdhet ranë  
sytë u çuditën,  
ç'ngjyra që panë!  
Tani gjerdhet akoma duken  
në rrudhat e plakut flokëbardhë.  
Por valët që vijnë  
edhe këto i fshijnë.

## SA RRUGË KA

*Aksionistëve punëtorë.*

U ngrita herët në mëngjes.  
Dal në qytet.  
Ku shkojnë gjithë këta?  
Shumë nxitojnë.  
Sytë shikojnë përpara.  
Shkoj edhe unë me ta.  
Për të arritur atje ku duam ne,  
sa rrugë akoma ka!



## ME DHEMBJE LINDA...

Me dhembje linda,  
me dhembje u rrita  
dhe çdo gëzim  
me dhembje u përzie.  
Gëzimi që kam sot  
i shkund  
dhembjet që kisha dje.

## MENDJEN E KAM EDHE ATJE

Mendjen e kam edhe atje.  
Sa fëmijë, sa gra dhe sa burra  
nuk dinë ku të shkojnë,  
enden rrugëve,  
vriten,  
vdesin nga uria,  
qajnë dhe zemërohen,  
po çojnë grushtin dhe qielli gjëmon.

Mendjen e kam edhe atje.  
Zemra ime nuk do të jetë e qetë,  
derisa dhe atje  
liri të ketë!

## NE JEMI BËRË

Ne jemi bërë nga balta jonë e ëmbël,  
pastaj ne kemi marrë  
fuqinë që rrënjët e rrapit kanë,  
jemi bashkuar me furtunat,  
dallgët e detit tonë  
në zemër i kemi vënë,  
shkëmbinjtë e maleve të lartë  
qëndresën shekullore na kanë dhënë  
dhe qielli ynë  
sytë na ka mbushur me kaltërsinë, --  
prandaj e duam Shqipërinë.

## ËNDRRAT E MIA DO VAZHDOJNË

Gjithë ëndrrat që pata dikur,  
i mblodha një nga një.  
Ëndrrat që më digjnin,  
disa që rrinin larg dhe më shikonin, —  
i mblodha një nga një.  
Të tjera ëndrra erdhën,  
më rrinë pranë dhe më thonë:  
— Eja me ne, ç'pret më?  
Ëndrrat nuk mbarojnë.  
Edhe kur unë të mos jem,  
të tjerët  
ëndrrat e mia do t'i vazhdojnë.

## UNË E SHIKOJ

Unë e shikoj dhe sytë e mi  
dritë lëshojnë pa pushuar.  
Ç'na jep ajo, me ç'bujari,  
je nëna jonë, o tokë, ti.  
Sa të jesh ti dhe unë me ty,  
të përqaftuar që të dy.

## NËN HIJEN E RRAPIT

Nën hijen e rrapit shekullor,  
në fshatin tim,  
kështu ka qenë gjithnjë.  
Po ai diell,  
ka rënë mbi të.

Nën këtë hije kushedi,  
sa herë janë mbledhur në kuvend,  
ç'vendime kanë marrë, ç'kanë thënë,  
sa herë është zënë me gojë fjala liri,  
sa herë për luftë janë betuar!...  
Nën këtë hije sot,  
janë mbledhur përsëri  
dhe pikturojnë së bashku një tablo,  
që do të thotë bukuri.

## KASOLLES

Kasolle e urtë, mënjanë je kthyer,  
tani ti brenda s'ke njeri.  
Sa herë fshatarët të kalojnë pranë,  
kur shkojnë në punë me nxitim!  
Të gjithë të shikojnë me përçmim.  
Po unë e di,  
si ke duruar  
gjithë atë varfëri!  
Që të shuante etjen mundimi pak,  
s'kishe asnjë sapllak.  
Sot  
në fund të fshatit rri  
jetime, po flet,  
u tregon fëmijëve syshkruar,  
sa vuajtje mbi ty kanë rënduar!

## DHE DIELLIT NJË PUTHJE I DËRGOJ

Gruri është rritur dhe lukuqet  
kanë dalë përmbi të dhe e shikojnë.  
Dhe unë kam qëndruar aty pranë,  
me sytë e mi jam futur në kallinjte.  
Dhe thith aromën që lëshojnë kokrrat,  
ngopem, veten e harroj  
dhe diellit një puthje i dërgoj.



## KUR DIELLI LËSHOI MË SHUMË DRITË

Nesër, kur unë s'do të jem më,  
zogjtë do të vijnë mbi mua  
dhe do të këndojnë  
këngët, që unë këndova atë ditë,  
kur dielli lëshoi më shumë dritë.

## SE KANË ZBRITUR YJE

*Dëshmorëve*

Pse kanë dolë sot  
në rrugë kaq njerëz?  
Pranvera erdhi? Ç'do të jetë?  
Rri e shikoj,  
sa sy të bukur kanë!  
Dhe lart,  
një qiell i kaltër pa kufi.  
E di, është mbledhur sot i gjithë atdheu,  
se kanë zbritur yje në çdo shtëpi.

## KATËR SHQIPONJA

Këtu u vranë katër partizanë.  
Lanë çdo gjë që kishin,  
nuk e duronin robërinë.  
Me këmbë zbathur e kaluan  
gjithë Shqipërinë.  
Ishin katër shqiponja,  
që mahnitën rrufetë  
me trimërinë.

## I DUA

I dua shokët  
me ëmbëlsinë e pranverës.  
Ata më kanë ndënjur gjithnjë pranë.  
Kam lozur me fjalët e tyre  
si fëmijët me ëndrrat e bukura.  
Por gjithnjë bashkë,  
edhe me ata që ranë.

## FJALËT S'I ZININ DOT

Të nesërmen nuk e pamë më.  
Ç'kish ndodhur? E kishin zënë spiunët,  
ndërsa shpërndante traktet e partisë.  
E futën në një birucë. E rrahën  
sa mundën. Ai s'tha asnjë fjalë.  
Po fjalët e traktit u shpërndanë.  
S'kishin ç'të bënin,  
fjalët s'i zinin dot, i lanë.

## NJË TUFË BUZËQESHJE

Një tufë buzëqeshje po të sjell  
si lule i kam mbledhur,  
që ditën që u njoha me birin tënd.  
Mblodha dhe buzëqeshjet  
e viteve që erdhën,  
ahere kur të lirë u putha me sytë e tij,  
që kishin perënduar.  
U bë një tufë e madhe,  
saqë s'e mbaj, o nënë, dot në duar.  
Po lulet më të bukura, në këtë tufë,  
që zemrën time kanë marrë,  
janë,  
buzëqeshja jote ditën kur e linde  
dhe buzëqeshja tjetër, o nënë,  
që le në lapidar.

## FËMIJA QESHI

Fëmija qeshi, dhe atë ditë  
qesha dhe unë si ajo.  
Dhe një piktor më pa.  
«Rri, qëndro ashtu! — më tha. —  
Dua, që kështu të qeshësh gjithnjë!»  
Portreti që më bëri, në mur qëndron,  
dhe si fëmijë më tregon.  
Flokët e bardhë m'i mbulon.

## VALLE MYZEQARË

Përpiqi këmbët fort. Kështu e shkele skllavërinë.  
Gjëmo, o valle myzeqare.  
Ta dish se si kënaqem, kur të shoh!  
Kujtoj kohën e shkuar,  
kur këmbët hiqje zvarrë,  
zemrën të kishin vrarë.  
Tani gjëmo, o valle myzeqare!  
Oxhaku frymë merr lirisht,  
toka lëshon përherë lastarë,  
era e freskët hyn e del nëpër shtëpitë.  
Në vallen tënde sot,  
janë mbledhur së bashku,  
këngët e shekujve të shkuar, —  
dertet, gëzimet, vuajtjet, trimëritë,  
të mbrujtura me dritë.



## NJË ERË E KËNDSHMË

Ftoi në dritaren time lëshoi lule të bardha.  
Çdo mëngjes i përshëndes  
dhe, çdo herë, i shikoj  
që ato ndryshojnë.  
Biseda jonë do pushojë,  
kur ftonjtë do të rriten.  
Por do të jenë rritur në gjithë Shqipërinë.  
Me një erë të këndshme  
do të na mbushen mushkëritë  
dhe të gjitha shtëpitë.

## TA ZËMË KOHËN

Ta zëmë kohën,  
të mos e lëmë të na kalojë.  
Ikën, s'kthehet.  
Si ujët e lumit që shkon në det.  
Koha matet me atë që bëjmë,  
me gurët që i vemë godinës së re.  
Më merrni edhe mua!

## ÇDO DITË GJËRA TË REJA SHOH

Gjëra të reja shoh çdo ditë,  
rruga e djeshme s'është më.  
Shtëpia blozëshumë është rrëzuar,  
një tjetër është ngritur, me tre kate.  
Dua t'i kujtoj të gjitha këto,  
o, si s'i kam harruar!  
Me miqtë e vjetër rrugës kur takohem,  
kujtimet e së shkuarës na vijnë,  
më tej takohem me një mik të ri,  
ai të tjera gjëra di.

Po që të gjithë atdheun po shikojmë,  
se si në sytë tona ndrit gjithnjë.  
Ecim krah për krah, si vëllezër,  
dhe këngë të reja po dëgjojmë.

## TOKËS SIME

Është shkruar mbi tokën time  
dashuria që kam unë për të.  
Nuk të lëshoj,  
nuk të ndaj nga sytë e mi,  
nuk të lë të të lëndojnë të tjerët,  
farë të pastër do të hedh mbi ty,  
njerëz të mirë do të të shikojnë,  
pemë të larta do të ngrihen,  
misër dhe grurë do të rritet shumë,  
djersë dhe dritë do të derdhen si lumë.  
Në gjirin tënd do të pushoj,  
po dhe atje, o toka ime,  
do të rrahë për ty  
pulsi i zemrës sime.

## AROMA E TOKËS

U ngrita herët në mëngjes.  
Lulet e ftoit në dritare,  
qielli lart që ndrit,  
edhe aroma e tokës,  
që u fut në dhomën time,  
m'i sollën prapë të ritë.

## MATERNITETI NË FSHAT

Materniteti në fshat nuk pushon.  
Ecën jeta, fytyra të reja përkëdhelen  
me ajrin tonë, qeshin sapo lindin.  
Lehona ka dalë në derë,  
e presin vjehrra, vjehri, burri i saj,  
nuk dinë ç'të thonë, s'flasin,  
flet shikimi i tyre.  
Ata thonë nga një fjalë,  
që s'e kanë thënë ndonjëherë,  
fjala u arrin deri në buzë, pastaj mbetet.  
Shikojnë, të tjerët, shikojnë,  
të gjithë shikojnë derën e maternitetit.  
Au, au, bën fëmija,  
që do të thotë se këtë herë  
me të vërtetë ka lerë.

## SONTE

Sonte nuk shkruaj, mendoj.  
Kur të flë, s'e lë mendimin të këputet.  
Le të vazhdojë, se nesër në mëngjes  
në gëzimin e njerëzve do futet

## N E S Ë R

Nesër do jem dhe unë.  
Nuk ndahem kurrë nga ky vend.  
Me agimin e mëngjesit do të puth  
atdheun tejpërtej.  
Kur dielli do të bjerë,  
do jem dhe unë me të.  
Me buzëqeshjet e kuqe të njerëzve,  
që gjithë tokën do mbulojnë,  
botën do përkëdhel,  
botën që kaq kohë zemra ime priste,  
botën komuniste.



## ETJA

Etje kam pasur për liri, —  
në zjarr u hodha, —  
për bukë, ujë, ajër.  
Tani kjo etje s'është ajo,  
që ish dikur.  
Sot etja ime s'ka mbarim,  
dua, që gjithë bota  
të vijë me mua në marshim.

## MË KANË LËNË GJURMË

U lodha duke mbajtur dhembje shumë.  
Dhembjet e vjetra  
më kanë lënë gjurmë.  
Gjurmë në zemër, në fytyrë,  
në fjalët që i them ngadalë,  
në zemërimin që shpërthen  
si valë,  
kur dikush shkel mbi drejtësinë,  
në grushtin që shtrëngoj,  
kur shoh  
se akoma ka në botë  
uri e lotë,  
se akoma derdhet gjak  
për më të dashurën, lirinë,  
se ka akoma njerëz,  
që shfrytëzojnë njerinë.

## MOS MA MBYLL DERËN

Dua të marrë në duar gjithë pranverën.  
S'ngopem duke parë  
kaq lule,  
kaq dritë.  
S'ngopem duke dëgjuar  
kaq fjalë të ëmbla, që thonë fëmijët,  
kaq tinguj të bukur, që thotë bilbili.

Dua të marrë në duar gjithë pranverën.  
Të lutem, vdekje, prit edhe ca,  
mos ma mbyll derën!

## I RI BËHEM DHE UNË SI ATA

Çdo ditë të rinjtë  
më të rinj më duken.  
Po unë nuk nxitohem.  
Nga sytë e tyre marr  
qartësinë,  
fytyrën u shikoj,  
fytyra ime rrudha s'ka,  
i ri bëhem dhe unë si ata.

## PASQYRA E LËNDËS

### NUK I HARROJMË

Atdhe .....	5
Nuk i harrojmë! .....	6
Në dorën time .....	7
Kështu vazhdonte jeta .....	8
Nëna nuk qau .....	9
Të gjitha më mungonin .....	10
Loti .....	11
Dhe unë me të .....	12
Shokëve të rënë .....	13
Akoma më djeg .....	14
Sa shumë gjak .....	15
Këtu .....	16
Kur u ndamë .....	17
Edhe ti .....	18
Ai .....	19
Dheu nuk e treti .....	20

Në tokën tonë ka lënë .....	21
U ulëm vetëm një herë .....	22
Flamuj të kuq valojnë .....	23
Ke hipur mbi majën e kullës .....	24
Djersa ime .....	25
Rini .....	26
Sot ngre dolli .....	27
Uria rri si kërcënim .....	28

## NJË RRUGË

Një çikë .....	31
Cërkami .....	32
Në një gufallë .....	33
Lubia padrejtësi .....	34
Rri pranë shkëmbit .....	35
Drënjë .....	36
Do të ndahemi .....	37
Edhe veten tënde do bëje fli .....	38
Dritë të kuqe mori nga ai .....	40
Varret e të parëve janë kudo .....	41
Ka çaste .....	42
Kallot .....	43
Postieri më sollti një letër .....	44
Në zemrën time .....	45
Kur binte shi .....	46
S'është më .....	47
Po këtë herë dielli s'ish ai .....	48
Dhëmbët i kishin rënë .....	49
Ajo dorë .....	50
S'numërohen dot dollitë .....	51

Ç'dhëmbje do të ndiej .....	52
Një rrugë .....	53
Ti rri me lulen bashkë .....	54
Rrezet e agimit .....	55
Averma .....	56
Furatë .....	57
Gardhi .....	58
Sa rrugë ka .....	59
Me dhëmbje linda .....	60
Mendjen e kam edhe atje .....	61

## TA ZËMË KOHËN

Ne jemi bërë .....	65
Ëndrrat e mia do vazhdojnë .....	66
Unë e shikoj .....	67
Nën hijen e rrapit .....	68
Kasolles .....	69
Dhe diellit një puthje i dërgoj .....	70
Kur dielli lëshon më shumë dritë .....	71
Se kanë zbritur yje .....	72
Katër shqiponja .....	73
I dua .....	74
Fjalët s'i zinin dot .....	75
Një tufë buzëqeshje .....	76
Fëmija qeshi .....	77
Valle myzeqare .....	78
Një erë e këndshme .....	79
Ta zemë kohën .....	80
Çdo ditë gjëra të reja shoh .....	81
Tokës sime .....	82